



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 36

Datë: 05. 07. 2017, ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi. Përkthyes: Vera Dula

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)**
- 3.. Raport i Këshillave të KQZ-së;**
 - **Këshilli për Çështje Ligjore;**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Gjiilan dhe Prishtinë ;*
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zgjatje të orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së për zgjedhjet lokale 2017;**
- 5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik, për Zgjedhjet Lokale 2017;**

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për kompensim shtesë për anëtarët e KQZ-së dhe zyrtarët e SKQZ-së, për zgjedhjet lokale 2017;

7. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në mbledhjen e 36. Rendi i ditës i cili, është para jush. A ka vërejtje apo jo...?

Betim Gjoshi: Kryetare unë nuk kam vërejtje, por, nuk po e shoh askënd prej zyrës se e kam një pyetje për zyrën ndoshta në qoftëse na bashkangjiten ndërkohë, ose te fjalimi i juaj...

Valdete Daka: Po në rregull, drejtoresha është këtu.

Nenad Rikallo: Në të ndryshme, do të kisha dashur të diskutojmë, janë disa probleme emërimet e KKZ-ve...Do të dëshiroja, nëse do të kemi kohë...lidhur me emërimet e Komisioneve Komunale...

Valdete Daka: Mirë, e kemi propozimin e Nenadit. Dëshiron t'i shpreh disa qështje në lidhje me emërimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore. Kush është për këtë rend dite me këtë propozim shtesë. Faleminderit, vazhdojmë me pikën e parë. A deshte një pyetje Betim?

Betim Gjoshi: Po kryetare. Fillimisht katër qështjet që kam ngritur mbledhjen e kaluar, asnjërën nga këto nuk I kemi sot në rendin e ditës. E kam parë një progres një lëvizje kështu me e-mail, shkresa sa për transparenc por, po pres që brenda javës me përfundu me ato. Sa I përket zyrës e kam një pyetje të paktën nga dy kandidat për deputet kan pranuar sot nga një shqetësim se ju është ndalur paga nga institucionet e Kosovës. Të dy kan qenë personel që kan pasur pushime brenda fushtës edhe arsyetimi që ju është ndalur paga është se ju ka shkuar shkresë nga ne që gjithë ata që kanë qenë në garë që të ju ndalet pagesa deri në certifikim të zgjedhjeve.

Unë, tha z. Gjoshi, për korrektësi po kërkoj që ne të paktën të tregojmë që kemi bërë shkresë të tillë, aëherë, ne kemi gabuar. D.m.th. se edhe ligji thotë se që të mos përdoret pozicioni për detyrë zyrtare nën 1, nën 2 thotë që pjesa tjetër nëse marrin pushim, ligji I shërbimit civil gjatë fushatave zgjedhore, që pushimi mund të jetë me pages, pa pages varësisht qfarë lloj pushimi kanë d.m.th ëshë mirë ndoshta të na japin një sqarim këtu se njerëzve ju është ndalur paga, të paktën dy kandidat të tillë që janë mjek profesionist mpirëpo që nuk kanë të bëjnë me pozicionet e tyre politike, sot ma kanë shprehur këtë shqetësim edhe ju është ndalur pagesa. Ndoshta edhe kishte qenë mirë për hir të opinionit ndoshta edhe për hir të institucioneve ku punojnë ata, me dhënë një sqarim të till se ka mundur edhe të keqkutohet ndonjë shkresë e jona positive. Në qoftëse nuk është e gatshme tash mundet edhe më vonë nuk është problem.

Valdete Daka: Po urdhëro drejtoreshë...!

Miradije Mavriqi: Vetëm desha të ju njoftoj se në momentin kur certifikohen secilin kandidat për cilado zgjedhje, ne e dorëzojmë listën e kandidatëve të certifikuar ministrisë, asnjë shkresë tjetër përpos listës së kandidatëve të certifikuar të subjekteve politike. Shkresë tjetër, nuk ka nuk ka kërkuar askush as nuk kemi dorëzuar vetëm emra.

Adnan Rrustemi: Mbi çfarë baze i dërgohet lista e kandidatëve të ministrisë...?

Miradije Mavriqi: Ministria, e kërkon listën e kandidatëve të certifikuar, dhe ne e dorëzojmë vazhdimisht për çdo herë për çdo zgjedhje, kjo është... shkresë tjetër nuk është dorëzuar...

Valdete Daka: Mirë faleminderit, nëse s'keni ndonjë pyetje tjetër për zyren...

Betim Gjoshi: Edhe kolegu jonë pyeti ma heret se çfarë arsye i dorëzojmë ne listën për kandidatët e certifikuar, janë ligjet...është mirë me pas edhe kujdes kur ti dërgojmë shkresë, tash po i bie që na duhet me i dhan një sqarim ministries, me i tregu që dërgimi edhe qertifikimi i kandidatëve nuk nënkupton që ata duhet mu angazhu 1 muaj pa pages, por nënkupton që ata mos me përdor pozicionin e tyre conform ligjeve fuqi, edhe mendoj që duhet me dhan një sqarim të tillë, sepse ne nuk kemi arsye askënd me dëmtu, si u zgjedh si su zgjedh deputet që me u dëmtu për angazhimin e tij, se mbi të gjitha zgjedhjet kanë zgjatë mbi 30 ditë, edhe shkresa po l'u dërgojke deri në momentin qertifikimit të tashëm të rezultateve zgjedhore që i bier rreth 2 muaj, edhe ne mundemi me dëmtu, ne jemi ne proces zgjedhjeve lokale në qoftëse bëjmë veprime të tilla i bie që dikur mundemi me dëmtu 4-5 muaj, si në mungesë të sqarimeve tona si të tilla kshuqë mendoj që zyra mbas kësaj me ba kontakt me ministrin dhe me i dhan sqarimet e mjaftueshme.

Adnan Rrustemi: Duhet me pa qarte cili është roli i KQZ-së në këtë çështje edhe shumë i kufizim, d.m.th dispozita e ligjit për zgjedhje po vetëm se i oblogon palët në këtë rastë institucionet veq e veq, kandidatët me institucionet ku punojn me raportu me e ba njoftimin sikurse është përgjegjesi e këtyneve institucioneve ku punon ata kandidat në garë me e ba raportimin ose komunikimin me ministrin që i ekzekuton pagat, sepse nuk mendoj që duhet edhe nuk duhet me shku komunikimi me KQZ-në në këtë rast...Listat e kandidatëve, nuk mendoj që duhet me ju dorëzuar asnjë institucioni ato bëhen publike si për çdo palë, por edhe në këtë pikë nuk mendoj që vendimi i cilës cdo ministri të financave ose admistratës duhet me qenë aq arbitrare edhe oficion, duhet jo nga KQZ-ja e posht duhet me institucionet varëse, relevante, komuna, shkolla, universiteti, spitali, secilat këto me i drejtu secilin institucion me e ba vlerësimin, komunikimin edhe me vendos.

Ne, tha z. Rrustemi, në zgjedhjet e ardheshme lokale kemi me u perball me në masë më të madhe se do të ketë kandidatët ma shumë asambleistë etj, kështu që KQZ-ja nuk ka rolë në këtë pikë, kështuqë duhet me pas parasysh këtë d.m.th., s'ka pse me u përfshi, ligji ekziston përgjegjesit secili institucion i ka dhe le të përmbushë..

Betim Gjoshi: Që të jemi të qartë kryetare, edhe unë vet kam qenë dikur drejtues i një institucioni, janë dy nene të ligjeve përkatëse që marrin kufizime. E para është që askush resurset edhe pozitën zyrtare nuk mundet me përdorë për interesa të fushatës, edhe e dyta është ligji për shërbime ciliv edhe rregulloret e tij që thotë që personat që garojnë në zgjedhje nga shërbimi civil duhet gjatë periudhës së

fushates zgjedhore të marrin pushim. D.m.th. pushimi nuk e cek qfarë lloji kanë në dispozicion, a kanë pushim me pagesë nëse kanë, pushim pa pagesë nëse nuk kanë me pagesë. Kjo është ajo që rrjedhë derivate, por, prap është zgjidhje e vet institucionit jo zgjidhje e përgjithshme me një dërgim liste, si të till ndoshta kishte qenë mirë me vu në kontakt edhe kjo me qenë zgjidhja që mos ti bie se interpretimi i të gjitha institucioneve më tutje është që KQZ-ja ka kërkuar ndales dhe në bazë të saj e ka ndaluar, se po humbim minuta kohë tepër ndoshta duke besuar që në të ardhmen mos të ju hym në hak këtyre njerzve d.m.th. se qëllimi jonë si KQZ-ë është që të mos ta cenojm por as most a favorizojmë dikënd. Faleminderit.

Valdete Daka: Veç një sqarim Adnan, se nuk po më duket e logjikshme që institucioni mundet me interpretuar si kërkesë për ndalesë një listë. Nëse e kanë kërkuar listën ata është dashur të thonë për qka po e kërkojnë listën, përndryshe nuk mundet të interpretohet si kërkesë për ndalesë, atëherë gabim e ka ai institucion që e ka bërë atë ndalesë.

Adnan Rrustemi: Ne, kemi gabuar që ia kemi dërguar, edhe ne po e diskutojme në përgjithsi. E kemi të qartë që institucioni jonë i ka të kufizura përgjegjësit, nuk mendoj që është dashur të ia dërgojnë këtë list madje është dashur të kërkoj edhe shpjegime. Mirëpo janë dy padrejtësi që mund të bëhen këtu, e para ka mundësi që ju ndalet pagesa personave që vetëm nuk ju ka dhënë pushimi, kanë punuar d.m.th. nuk ju është kërkuar nga përgjegjësit e tyre të institucioneve me marr pushim ose të ju jepet mundësia dhe e dyta ka mundësi që njerëzit thjeshtë edhe nuk e kanë pasur këtë uinformacionin që e kanë të drejtën që të marrin pushim në këtë periudhë d.m.th. duhet me pas parasysh, është përgjegjisi e institucioneve ku punojnë që mos të ndodh kjo në zgjedhjet e ardhshme lokale.

2. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)

Valdete Daka: Vazhdojmë më tutje me pikën tjetër. Raporti nga qendra e numërimit dhe rezultateve. Urdhëro Burim...?

Burim Ahmetaj: Faleminderti Kryetare... Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve pasi është marr vendimi për rinumërimin e 117 vendvotimeve me kërkesë të PZAP-it që ka marr KQZ-ja vendim për ato vendvotime që të rinumërohen. Pra Qendra e Numërimeve dhe Rezultateve ka filluar menjëherë rinumërimin e tyre dhe ka përfunduar dje rreth orës 14:15 dhe i ka marr parasysh të gjitha ato ankesa të cilat është marr vendim për ato për tu rinumëruar dhe kanë qenë gjithsej 117 vendvotime prej tyre 15 vendvotime kanë qenë rinumërim i plotë . Mirëpo mund të theksojmë se ka pasur raste ku për shkak të mospërputhjeve edhe ka qenë për një subjekt politik faktikisht për një kandidat brenda një subjekti politik për tu rinumëruar për shkak të mospërputhjeve është dashur që në vendvotime të caktuara të bëhet rinumërim i plotë. Nga rezultatet pra, pas rinumërimit tek votat për subjektet politike diferenca nuk është shumë e madhe mund të theksojmë vetëm një vendvotim vetëm ku është diferenca e madhe për shkak se janë shënuar gabimisht votat tek dy subjekte politike është fjala për vendvotimin 20 68a/02d ku subjektet nuk kanë qenë të shënuara votat si duhet dhe tash është diferenca, që ka qenë diferenca 91 pra, ka qenë tek Nova Demokracia Stranka dhe Kosova Tyrk Adalet Partisi te ky vendvotim pra, tek këto dy subjekte është

bërë përmirësim dhe vendimit për rinumërim. Ndërsa duke ju referuar ankesave të kandidatëve pra, për votat e kandidatëve, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve në bazë të kërkesës i ka bërë rinumërimet dhe është evidentuar tek kandidatët nëse është e nevojshme mund të kthehemi kandidatë për kandidatë vetëm atë ndryshim çfarë e ka pasur dhe tash sa vota ka. Kandidati nga PAN Muharrem Nitaj ka pasur 0 vota para rinumërimit dhe tash i ka 51 vota pas rinumërimit sepse është gjetur se nuk janë shënuar saktë votat te kandidati Muharrem Nitaj. Në Lipjan në vendvotim 13 07 ankesa nga Selvie Alimi nga PAN është evidentuar që ka pasur 0 vota dhe tash pas rinumërimit ka 42 vota. Ankesa e kandidatit Fatmir Xhelili në Shtime në vendvotimin 22 01/02r pra ka pasur 0 vota dhe tash pas rinumërimit ka 4 vota pra, nuk janë shënuar saktë në formular të rezultatet votat e këtyre kandidatëve, pas rinumërimit janë bërë të gjitha këto korrigjime. Ankesa e kandidatit Mexhide Mjaku Topalli nga PAN pas rinumërimit pasi qe ka pasur 0 vota tash i ka 51 vota , po ashtu ankesa tjetër e Mexhide Mjakut ne baze te anekses ka pasur 1 vote e tash pas rinumërimit ka 78 vota , në Skenderaj Fadil Beka në vendvotimin 21 b0/01r ka pasur 0 vota që nuk ju kanë shënuar dhe tash pas rinumërimit i ka 85 vota. Ankesa që i referohet një vendvotimi në Deçan 01 08/01r ka pasur 0 vota tash pas rinumërimit ka 17 vota, ankesa e kandidatit Xhavit Zariqi para rinumërimit 0 vota dhe tash pas rinumërimit 25 vota, ankesa po ashtu nga Xhavit Zariqi prap 0 vota dhe pas rinumërimit 46 vota. Në Prizren Fikrim Damka pasi që ka pasur 5 vota dhe tash pas rinumërimit i ka 80 vota pra, të gjitha këto pas rinumërimit janë gjetur këto vota dhe janë shënuar në llogarit e kandidatëve pra, pas rinumërimit. Kandidati Blerim Grainca ka pasur 0 vota të shënuara dhe tash i ka 15 vota, kandidati Lutfi Zharku në komunën e Ferizajit ka pasur të shënuar 1 votë, tash ka 45 vota, Blerim Grainca Ferizaj ka pasur 0 vota, dhe tash i ka 31 vota. Elmi Reqica në Ferizaj po ashtu 0 vota ka pasur të shënuara dhe tash ka 30 vota. Ankesa e Ukë Berishës ka pasur shumë vendvotime ku prej tyre ndryshimet kanë qenë minimale, mirëpo edhe në disa raste ka pasur më pak vota se sa ka pasur të shënuara dhe pas mbledhjes të gjithë këtyre vendvotimeve rezulton se tash në rezultatet përfundimtare i ka 6 vota më pak se sa votat që i ka pasur të shënuara nga ato të shpallura. Pra. Disa vendvotime ka plus disa minus.

Prej të gjitha këtyre rinumërimeve që janë bërë në qendrën e numërimit dhe rezultatit, tash kemi rirënditje të votave të kandidatëve dhe kemi tri ndryshime në mandate në tri subjekte politike. Është fjala për subjektin politik 16 LAA ku Naser Osmani ka 7350 vota, dhe Imet Rahmani që ka pas rinumërimit 7272 vota që do të thotë Naser Osmani ka fituar mandat dhe Imet Rahmani ka humbur mandat pas rirënditje dhe pas rinumërimit. Tek subjekti 26 Kosova Demokratik Tyrk Partici, Fikrim Damka tash pas rinumërimit ka 2980 vota që do të thotë që ka fituar mandat dhe Mahir Jakgjillar 2928 vota që do të thotë që ka humbur mandat. Graxhanca Iniciativa Lista, Sllavko Simiq ka 12603 vota që do të thotë që ka fituar mandat dhe Branimir Stojanovic 12464 vota që do të thotë ka humbur mandat pra, këto janë ato tri subjektet politike te të cilat ka pasur efekt rinumërimi pas vendimit të PZAP-it dhe tash kemi rirënditje tjetër pra janë tri subjekte dhe tre kandidatë të cilët kanë humbur dhe kanë fituar mandatin.

Valdete Daka: Faleminderit Burim. Pra këto janë pas rinumërimit , ndryshimet të cilat kanë ndodhur në rezultate dhe tek lista e kandidatëve. Ndërkaq tek subjektet politike nuk ka ndryshime as në rënditje, ka ndoshta ndonjë votë por të gjitha këto do të publikohen në ueb faqen tonë. Po urdhëro.

Betim Gjoshi: Unë kam dy tema për ti diskutuar. Fillimisht e përgëzojë Qendrën e Rinumërimit dhe Rezultateve që për më pak se 24 orë e ka përfunduar rinumërimin këtyre 117 vendvotimeve që kanë qenë objekt i ankesës PZAP-it. Realisht disa kanë qenë objekt i dy apo tri ankesave edhe kemi pasur 105 vendvotime kujtoj të gjitha që janë rinumëruar, i ka përfunduar në afat optimal pra, sa më shpejt që ka qenë e mundur. Unë mendoj se çka duhet të përfshihet përveç këtyre që gjithsesi duhet të publikohen përfshirë edhe raportin që na ka sjell për secilin vendvotim. Neve ka qenë mirë që për 971 kandidatët të publikohet gjendja para numërimit dhe gjendja pas numërimit apo plus minusi i votave, praktik që e kemi bërë në të kaluar, kjo është shumë më mirë që të shohin të gjithë si ka rrjedh si proces. Kjo ka qenë jashtëzakonisht e mirë, që mos të merren vetë deputete me mbledhjen edhe zbritjen e votave tyre. Sa i përket rinumërimeve që ka ndodhur me kërkesë të PZAP-it, se ne kemi shpallur rezultate përfundimtare ka përfunduar procedura e rezultateve përfundimtare, tash si rezultat i vendimeve të shkallëve tjera ka ndodh deri të ndryshimi. Edhe e dyta që mendoj që është një thirrje jashtëzakonisht e rëndësishme, ne kemi marr një varg masash që ta përmirësojmë procesin e numërimit të votave për parti edhe për kandidat, edhe me vëmendje i kemi lexuar edhe raportin e Bashkimit Evropian që e ka bërë për punën e Komisionit Qendror Zgjedhor të cilën e vlerëson me nota të larta pozitive po, mendoj që edhe ai ka vërejtur disa, edhe ne ka kohë që i kemi vërejtur disa problematika që kemi. E para, kemi parë që komisionerët jo në të gjitha rastet kanë arritur të vlerësojnë çka është votë e vlefshme e çka pavlefshme edhe Bashkimi Evropian e ka dhënë vlerësim që në doracakët që ne kemi saktë paraqiten format se cila është votë e vlefshme e cila e pavlefshme. Ligji është shumë i qartë, thotë sa herë të shihet qëllimi i qartë i votuesve, po më kujtohet edhe në 2007 kur kam qenë trajner në atë kohë bashkë me doracak kanë qenë të paktën 10-15 shembuj të cilat i kanë paraparë votat e vlefshme të pavlefshme se po e shohim në rinumërim që ka pasur paqartësi, e para. E dyta, mendoj që institucionet e Kosovës, Presidenti edhe Kuvendi i Kosovës duhet të filloj menjëherë pas konstituimit të Kuvendit, një procedurë të reformës zgjedhore që duhet të përfshihet edhe të shihet edhe nga masa mënyra se si duhet të mbrohet, nuk po them as të mbyllen listat as të hapen por, të shihet se si është më lehtë numërimi më i saktë i votave sa i përket kandidatëve se po vazhdojmë të kemi probleme, 425 kuti i kemi rinumëruar si rezultat i detektimit nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve për shkak të pasaktësive të votave për kandidatë. Kanë qenë 3 ose 5-6 mos të them për çështje të partive por, pjesa tjetër kanë qenë për çështje të kandidatëve e para, dhe kanë 117 vendime të PZAP-it kanë pasur të bëjnë me rinumërimin prapë të votave të kandidatëve që po shihet që prapë nuk mbërrin te standardi i numërimit të saktë të votave sa i përket kandidatëve, jo me fajin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve as me fajin e Komisionit Qendror Zgjedhor por, pak me problematikën që e ka vetë sistemi zgjedhor pastaj edhe me nivelin e trajnimit jo të duhur e shumë të tjera, që ja vlen të analizohen por, mbi të gjitha ne nuk mund të humbim kohë se jemi nga 2007 duke u sillur rreth këtij problemi, që po kemi problem rreth votave të kandidatëve. Pra, është mirë sa më shpejt me marr masa, neve nuk na mbetet asgjë më shumë se sa ta përfundojmë punën tonë, të ju përgjigjemi d.m.th vendimeve të institucioneve tjera, të ofrojmë transparencë sa i përket kandidatëve që kanë qenë në garë por, mos harroni se të gjitha këto rinumërime d.m.th. mbi 25 % të rinumërimeve neve na humbin besimin te opinioni edhe te vetë kandidatët që kanë qenë në garë pa fajin tonë. Për këtë d.m.th. duhet institucionet e Kosovës me marr masa që ta përmirësojnë këtë sistem zgjedhor i cili po shihet në mënyrën se si është ndërtuar nuk është shumë efikas ose të gjejmë një mënyrë tjetër të cilën e kanë propozuar në një mbledhje, ju e dini para zgjedhjeve që ne në secili në vendvotim me dërgu nga një sekretar i cili është punëtor administrativ i cili

do të përkujdeset për mbushjen e formularëve i cili do të jetë në nivel të detyrës më të lartë për shkak të pozicionit të punës që ka. Por, këto janë për të ardhmen, ti shohim masat të cilat duhet të merren por, gjithsesi në këtë mënyrë po funksionon. Nuk po kemi saktësi të duhur, unë d.m.th uroj që sa më shpejt ta mbyllin këtë procesin e certifikimit të rezultateve. Po presim që vendimet e gjykatës supreme që të vazhdojmë më tutje. Faleminderit edhe një herë Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Valdete Daka: Po Adanan..?

Adnan Rrustemi: Është e vërtete pjesa e tabulimit dhe shpalljes së rezultateve është bërë një aspekt shqetësues përkundër argumenteve që duken që e arsyetojnë, në anën tjetër në raport edhe me publikun edhe palët e përfshira në proces zgjedhor të pajustificueshme. Megjithatë i kamë dy çështje, një kërkesë për sqarim nga QNR-ja sepse siç e dimë ose për aq sa kam mbërritur unë të analizoj rastet që kanë shkuar në rinumërim si rezultat i ankesave në PZAP-ë, përgjithësisht janë ankesa për zhvillimet në vendvotim dhe jo për lëshimet, gabime ose pasaktësi ose mospërputhje në QNR-ë. Megjithatë po më duhet e dhëna e saktë sa janë nga këto 117 raste, ankesat që kanë të bëjnë me mospërputhjet nga aktiviteti në QNR-ë, nga futja e të dhënave të zyrtarëve të QNR-ës dhe pjesën tjetër e kemi parë që kanë të bëjnë me zhvillimet në vendvotim dhe sa i përket kësaj çështje e që mendoj që ka mundur së paku të përshpejtohet dhe mos të përsëritet e që duhet edhe me PZAP-in të zhvillojmë një komunikim më intensiv sepse PZAP-i e ka përgjegjësin për mospërputhjet ose për pasaktësitë në plotësimin e formularëve në vendvotim, e ka pasur afatin 24 orë pas mbylljes së vendvotimit që të trajtohen ankesat edhe ta udhëzojnë KQZ-ën që ti bëjnë rinumërimet para kësaj faze, para shpalljes së rezultateve përfundimtare që e kemi bërë. D.m.th. sepse nuk janë pasaktësitë që kanë ndodhur në QNR-ë por, janë pasaktësi që kanë ndodhur në vendvotim dhe kjo së paku na e kishte shmangur, i kishim bërë rinumërimet në kohën kur i kemi bërë rinumërimet si rezultat i pasaktësive që i ka detektuar vetë QNR-ja. Sepse ka raste kur PZAP-i i ka refuzuar si të pabazuara ankesat që janë bërë 24 pas mbylljes së vendvotimit për të njëjtat çështje, në ndërkohë i ka miratuar ankesat pas shpalljeve të rezultateve nga kandidatë të caktuar. Neve na duhet të qartësojmë, sa janë raste prej këtyre 117 që kanë ndodhur në vendvotimeve dhe sa eventualisht në QNR-ë se është e rëndësishme të dihet se sa raste rezultojnë si rezultat i mospërputhjeve në QNR-ë. Sa i përket kësaj çështje unë mendoj që duhet të bëjmë një analizë për sa na përket neve si KQZ-ë, aq sa kemi përgjegjësi dhe rol të krejt këtij aspekti, të analizohet sa më saktë, nuk duhet të përfundohet në një mbledhje e në ngritje të çështjes brenda mbledhjes, duhet një analizë e gjerë e kujdesshme të shihet nga po buron, cili aktivitet e përmirëson e cili jo, çka duhet me ndërhy kësaj infrastrukture ligjore që vërtete të mos na përsëriten rastet kur i rinumërojmë 400-500 kuti, se kjo nuk bëhet më fjalë për të ruajtur integritetin dhe besueshmërinë sa do të arsyetuara të jenë. D.m.th. neve po na merr kohë shpallja e rezultateve më shumë se sa vetë përgatitja e procesit zgjedhor. Duhet të shihet komplet procesi edhe i trajnimit edhe nominimet e komisionerëve edhe dokumentacionin ndërlikueshmërin që kanë, të dhënat që kërkohen por, edhe bazën ligjore pse jo?

Valdete Daka: A kemi ndonjë rast ku ka pasur mospërputhje nga QNR-ja?

Burim Ahmetaj: Është fjala vetëm për dy raste ku ndërlidhet me votat me post. Ato janë dy raste të cilat i referohen Qendrës Numërimit dhe Rezultateve, përndryshe rastet tjera të gjitha ndërlidhen me vendvotime. Mirëpo, më duhet të theksojë se një pjesë të rasteve nuk janë shënuar votat saktë të

kandidatëve, mirëpo ka pasur edhe raste kur nuk është shënuar në fletën origjinale të formularëve të rezultateve nuk ka të shënuara vota, mirëpo ka në fleta tjera që faktikisht për Qendrën e Numërimeve dhe Rezultateve ato nuk janë burimi prej nga i marrim të dhënat. Por, për këtë rast kanë qenë disa vendvotime të cilat edhe janë rinumëruar për arsye se ka pasur vota 0 për një numër të kandidatëve. Ndërsa sa i përket raportit, raporti është në detaje për secilin vendvotim që është rinumëruar, nëse është rinumërim i plotë ose rinumërim vetëm për atë subjekt, është në detaje do të jetë në EXEL dhe do të jetë në ueb faqe për të gjithë publikun.

Adnan Rrustemi: Kryetare, desha kryetare se mbetëm barxhë edhe diçka. Përveç këtyre është mirë të prezantohen kopje të skanuara në ueb faqen tonë edhe krejt format, përveç formës elektronike dhe thashë një raport detaj për secilin kandidatë jo për vendvotim, por, rezultatin e përgjithshëm, X personi i ka pasur para rinumërimit 100 mijë vota sot i ka 9999. Kjo të ketë plus minus e kemi bërë në të kaluarën që me pas secili një rrjedh totale të vendvotimeve kjo është e parë që mund të bëjmë. E dyta, ne e dimë që nuk kemi pasur procedura për të hapur kuti përveç atyre ka detektuar sistemi softuerik, se për ndryshe shumicën e këtyre kutive na është dashur ti numërojmë vetë se kemi pasur argumente me kohë edhe njoftime prej komisionerëve edhe prej kandidatëve, besa edhe shkresa zyrtare në KQZ-ë që ju ka gabuar 45 ju ka vendosur 46, pra, në raste tilla që ishte dashur të numërohen por, nuk kemi pasur procedura të tilla se ka ndodhur edhe si rezultat i gabimeve njerëzore. Lista e parë që e lexoj Burimi të gjitha janë tilla, që ne kemi qenë të njoftuar edhe PZAP-i ka qene i njoftuar siç e tha kolegu më herët. Nuk dua të arsyetoj se ata janë arsyetuar se nuk kanë marr vendim me kohë por, kemi marr tash se na kanë thënë personat në kontakt që kanë qenë të KQZ-ës me ta dhe d.m.th. që është e dëshmuar ajo punë që u kanë thënë ashtu ka qenë faji i tyre, e kanë interpretuar keq ligjin d.m.th. se ankesat për vendvotim kanë përfunduar 24 orë pas mbylljes së vendvotimeve ose 24 pas përfundimit të numërimit për rastet që kanë të bëjnë me numërimin. Por, ju kanë interpretuar keq edhe mos të gabojnë ta deklarojnë në mënyre të tillë se mund të na sjellin telashe, kanë qenë të vonuara këto që kanë qenë në vendvotim. Por, duke u bazuar se qëllimi i tyre ka qenë që ta sjellin vullnetin e qytetarëve në vend të duhur atëherë kemi vazhduar më tutje, se në raste të caktuara cilindo rast që e kishe dërguar pran organeve tjera më të larta kishte humbur. Faleminderit.

Valdete Daka: Në qoftëse nuk kemi diçka tjetër, vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-ës. Këshilli i përgjithshëm i çështjeve ligjore. Atëherë kush është për miratimin e këtij raporti? Faleminderit. Atëherë vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Gjilan dhe Prishtinë. Po urdhëro Sami...?

Këshilli për Çështje Ligjore

- **Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Gjilan dhe Prishtinë**

Sami Hamiti: Faleminderit Kryetare. Në mbledhjen e radhës të Këshillit për çështje ligjore kemi shqyrtuar dhe miratuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit dhe të Prishtinës dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit edhe në rastin e parë edhe në rastin e

dytë janë plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore që të bëhet ky zëvendësim dhe unanimisht i është sugjeruar KQZ-ës që të miratoj zëvendësimin e këtyre anëtarëve të Kuvendeve Komunale.

Valdete Daka: Kush është që Mimoza Kadriu të emërohen anëtare e Kuvendit Komunal në Gjilan nga subjekti politik Aenaca për Ardhmërin e Kosovës AAK duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Adelina Berisha. Kush është për? Faleminderit. Kush është për, që Isamil Kasumi të emërohen anëtare I Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik LDK duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Flamur Shala. Kush është për? Faleminderit.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto zëvendësime

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik, për Zgjedhjet Lokale 2017

Valdete Daka: Unë jam që këshilli i mëhershëm të vazhdojë punën...!

Adnan Rrustemi: Kemi pasur vërejtjet tona, dhe kemi shprehur shqetësimin...sidomos te fletëvetomiet e pavlefshme etj. Informimi Publik për këto zgjedhje, duhet të ketë më shumë prioritete: Unë kam një vërejtje, sepse roli i këshillit është më strategjik lidhur me vevojat, fushatën etj. Mendoj se, duhet zgjerruar këshilli, anëtarët e tij...

Betim Gjoshi: Ne po e marrin pretekst me fol tash se e kemi para vetit një vendim që të emërojmë një këshill por, nuk është zgjidhje as këshilli as vendimi sot. Problemet te informimi publik është se ne, unë edhe në mbledhjet e kaluar për këtë propozova ne vetëm kemi hyrë në javën e tretë të përgaditjeve të zgjedhjeve lokale edhe ende nuk jemi uluar të shikojmë se qka mund të përmirësojmë duke u bazuar në ato mësimet e zëna që i kemi zënë me 11 qeshor. Një nga pikat e dobëta të gjithë e dimë që është informimi publik është pikë e dobët në shumë aspektë, nuk është një dimezional që me ardhë në të një vlerësim. D.m.th. duhet një analizë më të thellë. E para, punën që ne e kryem na ka mbetur trashëgimi që i ka mbi 10 vite nuk ka ndryshuar asgjë, e bota për 10 vite ka lëvizur shumë d.m.th. kan ndryshuar edhe burimet e informacionit, ka ndryshuar d.m.th. ka qenë posterit përpara burim i informacionit sa portali mediat e tjera elektronike , rrjetet sociale e shumë të tjera. Mandej mendoj që edhe qasja jonë se d.m.th qëllimin se qka dojna me mbrri te aj, na mas pakti kena për edukim votuesve në kampanjë të informimit tonë publik , ma shumë kena informim për disa aktivitete që janë sesa për informim publik , na listen votuese po thojna që nuk mujna me përmirsu por mujna mju tregu qytetarëve saktë që ata me pas sikur e kan vendvotimin ky është qëllimi i parë në qofse e kemi qëllim , e dyta po kemi shumë fletëvotime të pavleshme qëllimi jonë duhet me qenë jo veq me i informu qata që kanë me votu vetëm një subjekt e pesë kandidatë po me ja ngulit në kokë që kot votojnë pesë kandidatë pa e votu një subjekt edhe kjo me qenë gjatë në media , me qenë gjatë prej sodit se ska me ndryshu deri në ditën e zgjedhjeve , jo me qitë një ditë para zgjedhjeve edhe ajo mos mu vrejte se efekti i kampanjës zgjedhore para se me fillu fushata e partive politike se atëhere ata e mbulon fushatën tane elektorale , pra ne nuk e kena

strategjikisht e kryejna këtë farë detyre vetëm sa për normë nuk e kem kry për aq sa duhet me ariitë te qëllimi jonë , na nuk jemi tu fol për qëllimin , e qëllimin mendoj që nuk mujna me këtë vendim me rregullu edhe 50 vete nese i shtijna në këtë këshill të informimit publik nëse një kontratë sekretariati e bënë edhe nuk e ka të analizuar qëllimet e veta e nashta veç e ka ba atëhere na kot e bojna këshill se ata e kan ba me qene të furnizum brenda qasajna na smujm se idet e tyne janë të furnizime me një kontrate dhe veq se e kanë ba këta d.m.th nuk e kanë marrë për baze as të kalumën pakën me 11 qershor e kanë pa që vrejttet në Komision Qendror Zgjedhor që të rritet numri i medieve që të shikohet shikueshmëria e tyre që të rritet përdorimi i rrjeteve sociale që portalet ti kenë e të jenë pjesë e fushatës tonë , që të jenë në ballinën e tyre me u ndërlihdh me faqet e tona po ne as njo nuk e kemi pare në realitet d.m.th të gjitha portalet që na i lexojmë nuk e ka reklamën tonë se ndoshta përmes televizionit kemi pas kohë ma pak ti shikojmë pra këto janë vërejtje që na duhet mu ul edhe me i bë shpejtë sepse nuk ka kuërfar efekti nëse na flasim 20 ditë para zgjedhjeve thojnë jon kry krejt punt tash po flasmi une për sot e shprehi mendimin si kryetarja mendoj që këshilli ka qenë në krye të detyrës gjithpërfshirës aj që ka qenë më herët sa i përket antarëve të Komisionit Qendror Zgjedhor për pjesën tjetër nuk prish punë me u shtu e mu plotësue prej sekretariatit pra këtë jam për ta pasur parasysh, nuk është pune roli me draftuar dhe përmirsime teknike me pa si po funksionon fushata në aspektin makro , a po arrihen qëllimet, a janë targetuar grupet adekuate, ky aspekt na duhet. Sa për mi shkru njoftime të thjeshta e për me përmirsuar nuk është roli i këshillit. Se pastaj po përfundojmë këtu se nuk jamë kundër edhe unë aty me kontribu, por, po përfundojmë aty.

Adnan Rrustemi: unë mendoj që puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kshillave të informimit publik dhe administratet është reciproke. E përmenda pak më herët një dokument mbi bazën e së cilës punonë administrata, strategjia e informimit publik është dokument që e miraton Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi këtë bazë punon administrata dhe procedon me projekte konkrete pranë këshillit d.m.th. që këshilli e ka për obligim që ti miratoj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve d.m.th. si dokument bazik është strategjia që duhet ta përpunojmë ne dhe ta bëjmë ndryshimin.

Po ashtu, ndoshta kishte me qenë mirë që të angazhohen anëtarët tjerë që të jenë pjesë e këshillit, nesh kjo do të ishte e mundshme. E dyta, ne të gjithë e dimë që këshilli qfarë kompetenca ka i trajtonë materialet kryesisht të bazuara edhe në ligj, por, në qoftëse është nevoja edhe ndonjëherë nëse e vërejmë që ka probleme gjuhësore. Por, ne nuk jemi ekspert të gjuhëve të huaja, por, ndoshta edhe në vetë gjuhët tona që kemi ne kemi probleme. Për këtë edhe parashihet me ligj që të kontraktohet kompania e cila e bënë fushatën e bënë informimin publik sepse na nuk jemi expert të informimit publik edhe për ata po them që kjo pastaj kalon në një kompetencë tjetër të përgjegjsive të të kompanisë e cila e merr përgjegjësin me udhëheq këtë kampanjë , e dyta mendoj që edhe në zgjedhjet që sapo i kemi përfunduar kompania e cila i ka marrë mendoj që na sa kemi pas mundsi i kemi dërgu në të gjitha gjuhët zyrtare qoftë nivel qendror qoftë atë lokal dhe nuk e besoj që ka pasur ndonjë informim publik që transmetohen në gjuhën shqipe dhe nuk është transfermuar në gjuhët tjera për aq sa ka qenë e mundshme në përjashtim në një rast në Gracanicë ku një radio lokale ka tentu që informimi të mos jetë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës dhe natyrisht ne atëherë kemi kërku që atëherë të ndodh në media të tjera , por mendoj që në suaza të asaj kompetencave tona që dhe ligjet që na ofron ne e kemi përfunduar punën ton si këshill qe kemi qenë por ndoshta një rifreskim me

antarët e tjerë të cilët ndoshta kanë ndonjë ide tjetër, më të mira dhe kanë prirje sa i përket informimit publik kishte me qenë mirë që të jenë pjesë e këshillit në mënyrë që të ketë ndonjë produkt tjetër duke shpresuar që edhe kompania e ardhshme të jetë me profesionale për me trajtuar këtë qështje, faleminderit.

Në këtë pikë, diskutuan: Bajram Ljatifi, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Binak Vishaj. Sami Hamiti etj.

Valdete Daka: Atëherë, të rishikohet strategjia, të bëhet ndonjë shtesë...Por, unë propozoj që ky këshill të mbetet, por strategjia të rishikohet... Kush është që të mbetet këshilli i vjetër...?

Anëtarët e KQZ miratuan mandatin e këshillit të mëparshëm të Informimit Publik për Zgjedhjet Lokale me një plotësim: në vend të Nenad Rikallos, do të jetë Bajram Ljatiti.

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zgjatje të orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së për zgjedhjet lokale 2017

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër...? Po, ky është vendim i zakonshëm. Planin administrative, ne e dim që arritjet, aktivitetet dhe angazhimet nuk mund të përmbyllin disa qështje që kërkojnë afate të ngjeshura, sa do që zgjedhjet janë të rregullta, e ka bazën e vetë në kuptimin e implikimeve tjera që tërheq këto vendime, vendimet janë marrë më herët kështu që është një formalizim i angazhimit tonë gjatë kësaj periudhe.

Valdete Daka: Kush është pra që të zgjatet orari i punës...?

Valdete Daka: Atëherë kush është për këtë këshill? Emrat, sa e di unë, kanë qenë Adnani, Iliri, Nenad, Ercan edhe Eshrefi nga KQZ-ja mirë pra atë here po don me e zëvendëso at here ta qesim Bajramin at here ta zëvendësojmë Bajramin sepse na duhet dikush që e njëj at here kush është për Faliminderit

7. Të ndryshme

Valdete Daka: Athëre, Riklo e ka pasur një pyetje në të ndryshme...! Por, mendoj që duhet me marrë informata më të hollësishme edhe me u përgaditë përgjigje: A është e vërtetë masë pari kjo, apo jo...!

Enis Halimi: Unë, po provoj të përgjigjem parimisht për shkak se detajet të cilat u pyeten, nuk i di por për atë unë ju siguroj se vendimet e Komisionit Qendror të Qgjedhjeve zbatohet pa diskutim mundë të ndodh për shkak të zgjedhjeve për qështjet të cilat u ngiten këtu në këshillin e operacioneve zgjedhore por kemi pas disa plotësime të antarëve të këshillave komunale zgjedhore edhe eventualisht aty mun të ket pas eventuale në kuptim të prezantimit në këshillin e proceseve të KQZ-s për ndryshje vendimet e komisionit qendror të zgjedhjeve për neve janë ligje edhe këtë qështje e ketyre në komunën e Leposaviqit

edhe në Veri edhe në Zubin Potok dhe po ashtu edhe në atë të Graçanicës i kemi diskutu na këtu në këshillin e operacioneve dhe zgjedhore ndoshta mundë të mos jen paraqitur me saktësi duke bër ndryshime në kuptim të plot të fjales nga këshilli për mbledhje kurse ka egsitu nje trajtim ne këshill me pastaj ne KQZ dhe si i till dhe i miratuar ne por edhe nje here mund te themi nuk kemi ketu informata për ndonje shkarje eventuale teknike.

Betim Gjoshi: Aty se qka ngriti kolegu janë me te drejta në qofse ndodh ndonje divijimë të Komisionit Qendror Zgjedhor por është mir mos me u ngut me konkluzione ndoshta nuk ka shkarje të vendimit po ka tendenca se gjatë rruges për me manipulou na të sigurohemi per vendimin e KQZ-së tonaj mandej krahasohet me emrat dhe shqetësimet jan reale nëse ndodh ndonje devijim KQZ jo mu shqetsu gjith jo veq kolegu nëse vendimi i KQZ-s aj që ju ka prezantu në mënyr komunale zgjedhore me i emplimentu edhe per me marr masa ndaj tyre

Sami Hamiti: Mas pari duhet me vendos na në KQZ nëse është korrektësia këtu kryetare e drejt se pse ka drejt aj me qenë edhe pse ska drejt aj me qenë nëse prej nje iniciative jan bo dy subjekte në kët rast subjekti që ka qenë Lista Serbska iniciativa ka qenë një parti parlamentare këto ende nuk janë qertifiku mandej pse skan drejt ata me marr pjesë kjo është qashtje e tyre dhe është qështje e komunitetit por une konsideroj se edhe ata po ashtu kan drejt

Valdete Daka:Ta shikojmë shkresen at here dhe qysh ka qenë vendimi deshta vetem listen pse mediat edhe pse shumë herë mu kan drejtu sod lidhur me certifikimin e rezultateve edhe nje here po ju tregoj se na jemi duke i pritur nga vedimet e Gjykates Supreme lidhur me ankesat ndaj vendimit e ZAPIT dhe momente që kur i marrim vendimet të gjykates supreme për katësisht nga ato vendime ne do ti qertifikojmë rezultatet.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
